



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES URGJENTE TË KËSHILLIT TË LARTË
GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 11.09.2020)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 18:30 dhe mbaroi në orën 18:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*

RENDI I DITËS:

1. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Maksim Qoku: Përshëndetje të gjithëve.

Është një mbledhje urgjente e kërkuar nga Kryetari i Komisionit të Karrierës për efektin e situatës urgjente që ka në Gjykatën e Apelit Korçë.

Për më tepër ia referoj fjalën zotit Toska.

Fjala për ju!

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, nga Gjykata e Apelit Korçë ka ardhur një njoftim në rrugë elektronike për situatën që është krijuar, ndërsa janë në detyrë vetëm 2 gjyqtarë, ndërkohë që ndaj gjyqtarës {...} e skemës së delegimit, e caktuar më herët nga Këshilli për të ushtruar funksionin pranë Gjykatës së Apelit Korçë, është filluar procedim penal dhe është vënë nën masë sigurimi shtrënguese.

Pas kërkesës tonë për informacion të mëtejshëm, pas mesditës së sotme, na ka njoftuar që janë për shqyrtim disa kërkesa për caktim mase sigurimi në lëndë penale, i kishin planifikuar për ditën e sotme dhe i kanë shtyrë, ndërkohë që janë duke skaduar afatet e paraburgimit. Për këtë arsye kërkova që të mblidhet menjëherë mbledhja e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas edhe relacionit që ju është shpërndarë pak më parë, janë 10 çështje për të cilat Gjykata e Apelit Korçë ka nevojë për caktimin e 1 gjyqtari. Të 10-ta çështjet janë për caktim mase sigurimi.

Në këtë rast nuk mund të zbatojmë mekanizimin e skemës së delegimit, nuk kemi gjyqtarë në këtë skemë. Po kështu është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm dhe do duhet të zbatojmë vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka këto propozime: Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 10 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 10 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 1.

Kemi propozime vijuese sa i përket përjashtimit nga shorti të kryetarit në detyrë të Gjykatës së Apelit Tiranë, z. Ridvan Hado; po kështu të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë që është në përbërje të trupit gjykues që ka radhën e gatishmërisë, konkretisht: z.Asim Vokshi; gjithashtu gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë që nuk janë paraqitur në detyrë për arsye shëndetësore, konkretisht: znj. Zina Sollaku, z. Gramoz Levanaj; gjithashtu të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, të cilës i është akorduar leje afatgjatë nga ish-KLD-ja, leje që ka përfunduar më datë 01.04.2020, por që nga gjykata nuk ka ndonjë njoftim për kthimin e saj në detyrë, konkretisht: znj. Evjeni Sinojmeri.

Nëse s’keni ndonjë kundërshtim, do të procedojmë me shortin elektronik.

(Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime.)

Mirë atëherë, meqenëse Këshilli është dakord me propozimet e Komisionit, Valbona të procedojë me shortin elektronik.

Valbona Bako: Për 10 çështjet e Gjykatës së Apelit Korçë, përzgjidhet gjyqtare Valdete Hoxha.

Ilir Toska: Atëherë, sipas shortit elektronik u përzgjedh gjyqtare Valdete Hoxha.

Me kaq mbyllet procedura e shortit dhe kjo çështje e rendit të ditës.

Maksim Qoku: Faleminderit, zoti Toska!

Nëse nuk ka gjë tjetër, mbledhjen e konsideroj të mbyllur.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor